




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



KGJK.nr.404/2021
Datë: 08 dhjetor 2021

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK), në bazë të nenit 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7, nenit 28 paragrafi 1 i Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, nenit 5 paragrafi 1 dhe 2 të Rregullores nr. 15/2016 për Transferim dhe Caktimin e Gjyqtarëve, në mbledhjen e 273-të, të mbajtur më datë 8 dhjetor 2021, merr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet kërkesa e z. Nikollë Komani, Kryetar i Gjykatës Themelore në Gjakovë, për angazhimin/transferimin e përkohshëm jo më gjatë se gjashtë (6) muaj të z. Mentor Bajraktarit, gjyqtar në Departamentin Special në kuadër të Gjykatës Themelore Prishtinë, për përfundimin e dy (2) lëndëve me numër PKR.nr.191/20 dhe PKR.nr.110/2021, në Gjykatën Themelore Gjakovë.
- I. Vendimi hyn në fuqi më datë 08 dhjetor 2021.

A r s y e t i m

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, nga kryetari i Gjykatës Themelore në Gjakovë z. Nikollë Komani, ka pranuar kërkesën për angazhimin e z. Mentor Bajraktari, në përfundimin e çështjeve gjyqësore të mbetura në fund të shqyrtimeve gjyqësore në Gjykatën Themelore Gjakovë, për shkak të emërimit të z. Bajraktari, gjyqtar në Departamentin Special në Gjykatën Themelore Prishtinë.


KGJK, ka pranuar kërkesën e kryetarit të Gjykatës Themelore në Gjakovë, me shenjën A.GJ.nr.262/21, përmes së cilës kërkon që z. Mentor Bajraktari, të vazhdoj gjykimin e lëndëve në Gjykatën Themelore Gjakovë, për përfundimin e tyre me të cilat ka qenë i ngarkuar, të cilat janë në fund të shqyrtimeve gjyqësore.

Në takimin e mbajtur më 8 dhjetor 2021, Këshilli pas shqyrtimit të kërkesës së kryetarit Komani, vendosi që të aprovohet kërkesa dhe gjyqtari Mentor Bajraktari të transferohet përkohësisht deri

në përfundimin e lëndëve PKR.nr.191/20 dhe PKR.nr.110/2021, por jo më gjatë se një (1) vit, me qëllim të zgjidhjes efikase të lëndëve, ngritjes së efikasitetit dhe që këto lëndë të mos fillojnë rishtas.

Andaj, bazuar në këtë vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Albert ZOGAJ,
Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës



Kopje e vendimit i dërgohet:

- Z. Nikollë Komani, Kryetar, Gjykata Themelore Gjakovë;
- Znj. Albina Shabani Rama, kryetare e Gjykatës Themelore në Prishtinë;
- Z. Mentor Bajraktari, gjyqtar, Gjykata Themelore Prishtinë
- Sekretariatit të KGJK-së, si dhe
- Arkivit.